



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRRI

01 Nr. / Br 297/12

Nr. i fq. / Br. sf _____

Data: / Datum 30. 10. 2012

VUSHTRRI - VUÇITRRI



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12 dhe 58 "h" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 /2008, nenin 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/1202 MAPL për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi, nein 42.1, "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më **30.10.2012**, mori këtë:

V E N D I M

PËR THEMELIM TË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

Neni 1

1.1 Me këtë vendim, themelohet Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi në këtë përbërje:

- **Bajram Mulaku**, Kryetar i Komunës – Kryesues;
- **Abdylaziz Hoxha**, Komandant i Stacionit Policor – anëtar;
- **Jeton Bilalli**, Bashkësia Islame në Vushtrri - anëtar;
- _____ përfaqësues i Kishës Ortodokse Serbe – anëtar;
- **Dragisa Lazic**, përfaqësues i komunitetit serb – anëtar;
- **Agim Myftiu**, përfaqësues i komunitetit turk – anëtar;
- **Shyqyri Quni**, përfaqësues i komunitetit ashkali – anëtar;
- **Ferki Emini**, përfaqësues i komunitetit rom – anëtar;
- **Milan Kostic**, Kryesues i Komitetit për Komunitete - anëtar;
- **Remzije Zekolli**, Zyrtare për Barazi Gjinore – anëtare;
- **Qerim Selimi**, Drejtor i Drejtorisë për Arsim – anëtar;
- **Bajram Beqiri**, Kryetar i Këshillit të Prindërve të Arsimit – anëtar;
- **Bajram Kela**, FSK – anëtar;
- **Ismet Saraqi**, anëtar i Këshillit Lokal për Siguri në Bashkësi për fshatrat Bivolak Zhilivodë, Gllavatin, Prelluzhë, Stroc, Bequk dhe Mihaliq – anëtar;
- **Fatmir Feka**, kryesues i Këshillit Lokal për Siguri në Bashkësi për fshatrat: Bajskë, Gojbulë, Sllatinë, Tërllabuq, Karaqë, Begaj, si dhe BL "Kalaja" Vushtrri, anëtar;
- **Naim Hyseni** Drejtor i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim – anëtar;
- **Ekrem Merovci**, Zyrtar për Komunitete për Kthim dhe Riatdhesim – anëtar;
- **Fikrije Ferizi**, kryetare e shoqatës "Gratë për Gra" – anëtare;
- **Bahri Bivolaku**, Zëdhënës i Komunës – anëtar;
- **Subhi Metëhiu** përfaqësues i Komunitetit të Biznesit – anëtar;
- **Isak Hyseni**, Përfaqësues i Shoqatës "Handikos" në Vushtrri – anëtar.

Neni 2

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, dhe Kryesuesi i KKSB, detyrat dhe përgjegjësitë e tij do të i ushtrojnë në pajtim me Udhëzimin Administrativ të MPB-së Nr. 27/12 dhe MAPL-së Nr. 03/12 për themelimin e KKSB.

Neni 3

Mandati i KKSB është i njëjtë me mandatin e anëtarëve të kuvendit të komunës.

Neni 4

Anëtarët e KKSB, për pjesëmarrje në mbledhje, kompensohen në shumën prej 50 €, dhe vetëm për 6 (gjashtë) mbledhje të mbajtura brenda vitit kalendarik.

Neni 5

Në rast se anëtari/ja i/e KKSB nuk merr pjesë në tri mbledhje radhazi, apo për çfarëdo sjellje ose veprim e komprometon funksionimin efektiv të KKSB-së, me propozimin e kryesuesit të KKSB -së Kuvendi i Komunës emëron anëtarin tjetër të këtij këshilli.

Neni 6

Ky vendimi hyn në Fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.


Neni 7

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi 02Nr. 280/09 dt.28.04.2009.

Kryesuesi i Kuvendit

Habib Mustafa





Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në bazë të nenit 12 pika 2 "d" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 nenit 41.2 "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 30.10.2012, mori këtë:

V E N D I M

PËR LIRIMIN NGA PAGESA PËR SHFRYTËZIMIN E PALESTRËS PËR TË GJITHA KLUBET SPORTIVE DHE SHOQATAT E DALA NGA LUFTA E UÇK-së

Neni 1

Me këtë vendim lirohet nga pagesa për shfrytëzimin e palestrës të gjitha klubet sportive të komunës dhe shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së, Dega në Vushtrri.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

Habib Mustafa



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUČITRN

01 Nr. / Br 295/12

Nr. i fq. / Br. st _____

Data: / Datum 30. 10. 2012

VUSHTRRI - VUČITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më **30.10.2012**, pas shqyrtimit të Draft-rregullores për procedurat e dhënies së objekteve publike dhe tokës për shfrytëzim afatshkurtër përmes ankandeve në territorin e Komunës së Vushtrrisë, dhe duke u bazuar në nenin 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 12 të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të nenit 7-të të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/09 për transparencë nëpër komuna, mori këtë:

V E N D I M

Neni 1

Ipet në diskutim publik Draft-Rregullorja për procedurat e dhënies së objekteve publike dhe tokës për shfrytëzim afatshkurtër përmes ankandeve në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Neni 2

Diskutimi publik fillon nga data 31.10.2012 dhe zgjatë deri më 17.12.2012.

Neni 3

Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmer masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna.

Neni 4

Obligohet Komisioni për përmirësimin e menaxhimit të aseteve të Komunës së Vushtrrisë që si hartues dhe propozues i Draft-rregullores në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 2008/09.

Gjithashtu Komisioni në fjalë obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-Rregullores në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin Dhjetor 2012.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga kryesuesi i kuvendit.



Kryesuesi i Kuvendit

Habib Mustafa



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 294/12

Nr. i fq. / Br. st _____

Data: / Datum 30. 10. 2012

VUSHTRRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më **30.10.2012**, pas shqyrtimit të Draft-rregullores për procedurat dhe kriteret e vendosjes dhe mirëmbajtjes së përmendoreve, shtatoreve, busteve dhe simboleve në territorin e Komunës së Vushtrrisë, dhe duke u bazuar në nenin 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 12 të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të nenit 7-të të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/09 për transparencë nëpër komuna, mori këtë:

V E N D I M

Neni 1

Ipet në diskutim publik Draft-Rregullorja për procedurat dhe kriteret e vendosjes dhe mirëmbajtjes së përmendoreve, shtatoreve, busteve dhe simboleve në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Neni 2

Diskutimi publik fillon nga data 31.10.2012 dhe zgjatë deri më 17.12.2012.

Neni 3

Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmer masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna.

Neni 4

Obligohet Drejtoria për Shërbime Publike që si hartues dhe propozues i Draft-rregullores në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 2008/09.

Gjithashtu DSHP-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-Rregullores në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin Dhjetor 2012.

Neni 5


Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga kryesuesi i kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit


 Habib Mustafa



1. Jashari



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 40.2 "c" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 si dhe nenin 40.2 "dh" dhe 41.2 "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **30.10.2012** mori këtë:

V E N D I M
PËR RIDESTINIMIN E MJETEVE BUXHETORE TË KOMUNËS

Neni 1

Me këtë vendim bëhet ridestnimi i mjeteve nga fondi 21 nga kategoria e investimeve kapitale (programi 664180 - Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia), nga këto projekte:

1.1 Kodi i projektit 86150, riasfaltim i rrugëve, shuma e projektit 120,000.00 € nga ky projekt mjetet e lira në shumë 20,823.00 € ridestinohen në projektin me kodin 84342 "Fondi për bashkëfinancim me donatorë".


1.2 Kodi i projektit 86152 Transport, shuma e projektit 64,800.00 €, nga ky projekt shuma e mjeteve në vlerë 60,000.00 € ridestinet në projektin me kodin 84342 "Fondi për bashkëfinancim me donatorë".

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga kryesuesi i kuvendit.



Kryesuesi i Kuvendit

Habib Mustafa
Habib Mustafa